I lutemi Shpërndarësve tanë të nderuar që edhe në të ardhmen t'i kushtojnë kujdes plotësisht të saktë të formularëve, sidomos të fletës së regjistrimit të distributorit, e cila është kontrata ndërmjet distributorit dhe FLP-s! Formularët e korrigjuar dhe dhe të panëshkruar të regjistrimit dhe porosisë së produkteve nuk mund t'i pranojmë për shkak të shmangjes së gabimeve!

**Pranojmë vetëm kontratat me nënshkrim personal! Çdo nënshkrim tjetër konsiderohet si falcifikim dokumentash!**

Në rastin e ndryshimit të adresës apo të emrit s'është e mjaftueshme ta shkruani atë në fletën e porosisë së produkteve. Për këtë ju lutemi të përdorni formularin e ndryshimit të të dhënave!

Në interes të sigurisë së çështjeve financiare ju lutemi, që në rastin e kontrollit të pikëve nëpërmjet autorizimit, personi i autorizuar të sjell me vete letërnjoftimin e tij!

Sipas Politikës Ndërkombëtare të Biznesit, çdo distributor që nënshkruan formularin e regjistrimit (kontratën), fiton të drejtën e blerjes së produkteve me çmim shumice direkt nga zyrat. Ndërkohë distributor i regjistruar ai bëhet vetëm gjatë blerjes së parë, duke paraqitur 2 kopje të formularit të regjistrimit të vulosur dhe dorëzuar më parë.

## FLP TV

programi në internet  
nga 19 tetor deri  
në 23 nëntor 2009

06:00 dhe 18:00	Himni
06:10 dhe 18:10	Ëndrra jote është plani ynë: Hyrje në FLP
06:15 dhe 18:15	Dr. Ilona Juronics Vargane: Përgatitje për vjeshtë
06:35 dhe 18:35	Shfaqje kërcimesh
06:50 dhe 18:50	Hilda Pere: Histori suksesi
07:15 dhe 19:15	Supervizorë, Asistent m...
07:35 dhe 19:35	Menaxherë, Menaxherë drejtues, Sundimtarë
07:55 dhe 19:55	Zsolt Fekete: Krijim marrdhëniesh
08:30 dhe 20:30	Karner Eva: Këngë (nga Austria)
08:45 dhe 20:45	Tünde Hajcsik: Si e shfrytëzoj?
09:25 dhe 21:25	Istvan Halmi: Zgjerim
10:15 dhe 22:15	Ëndrra jote është plani ynë: Produktet FLP
10:20 dhe 22:20	Adagio: Koncert
10:45 dhe 22:45	Ëndrra jote është plani ynë: Mundësia FLP
10:50 dhe 22:50	Dr. Sandor Zsolczai: Aloe në praktikë, produktet e suksesshme të Forever-it
11:15 dhe 23:15	Jozsef Szabo: U nisa nga Stuttgarti, ndërkohë regjistrim i drejtpërdrejtë nga Gjermania
11:55 dhe 23:55	Ëndrra jote është plani ynë: Hyrje në FLP
12:00 dhe 00:00	Shfaqje kërcimesh
12:10 dhe 00:10	Dr. Csaba Gothard: Mposhtja e armikut të vjetër të rrjetndërtuesit
12:20 dhe 00:20	Mihaly Molnar: Mundësi të pafund me FLP-n
12:45 dhe 00:45	Supervizorë, Asistent m...
13:25 dhe 01:25	Ëndrra jote është plani ynë: Produktet FLP
13:30 dhe 01:30	Menaxherë, Menaxherë drejtues, Sundimtarë
14:25 dhe 02:25	Kualifikim për Poreç 2009
14:40 dhe 02:40	Diana Biro: Këngë surprizë
14:45 dhe 02:45	Marika Rozsahegyi: E shikon nëse e beson
15:15 dhe 03:15	Marta Zsiga: Ndërtë që të kesh mundësi
15:45 dhe 03:45	Hajnalka Senk: Qan apo qesh
16:20 dhe 04:20	Ëndrra jote është plani ynë: Mundësia FLP
16:25 dhe 04:25	Eszter Vegvari dhe Otto Magocs: Shfaqje muzikore
16:50 dhe 04:50	Slavka Mohova dhe Dezsó Szabo: Motivim nga Çekia
17:35 dhe 05:35	Miklos Berkics: Ju jeni më të mirët

[www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)



## NJOFTIMET E ZYRAVE TË HUNGARISË

### TË REJA

Telecenter zotëron edhe numër të ri TË GJELBËR: 06-80-204-983. Ky shërbim funksionon gjatë ditëve të punës në orarin 12-16 dhe mund të telefonohet falas. Natyrisht Telecenter mund të arrihet akoma edhe në numrat e vjetër: +36-1-297-5538, +36-20-456-8141, +36-20-456-8149

### KALENDARI I AKTIVITETEVE

BUDAPEST – Sucess Day: 2009. 10. 17, Sucess Day: 2009. 11. 21, Sucess Day: 2009. 12. 19

### POROSI PRODUKTESH

**Blerësit që i sigurojnë produktet jo personalisht, por me autorizim mund t'i bëjnë porositë e tyre në mënyrën e mëposhtme:**

– **në telefon**, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit: +36-1-297-5538, +36-1-297-5539,

– **cel**: +36-20-456-8141, +36-20-456-8149

– **me sms** në numrin e telefonit +36-20-478-4732.

– **në internet**: porosisni produkte në faqen e internetit [www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)! Zgjidhja më e thjeshtë dhe më e sigurt – jo vetëm përsa i përket blerjes së drejtpërdrejtë të produkteve, por edhe regjistrimit të porosisë. Është një mjet i shkëlqyer edhe gjatë rekomandimit të produkteve, pasi kjo ofertë është joshëse për çdo të interesuar. Vlera e pikëve të çdo porosisë brenda 24 orëve i shtohet vlerës aktuale. Dyqani ynë web mund të arrihet drejtpërdrejtë në adresën [www.flpshop.hu](http://www.flpshop.hu), kurse vlera e pikëve dhe mund të ndiqet me vëmendje në faqen e internetit [www.foreverliving.com](http://www.foreverliving.com).

### BLERJE ME ULJE

Partnerët tanë me shtetësi hungareze pjesën e shpërblimit që u takon për blerjet **personale** mund ta marrin në formën e uljes së çmimit. Sipas kërkesës suaj uljen e zbrisim nga shuma e çeqeve të blerjes, kështu që Ju paguani më pak.

Procesi i blerjes me ulje është si mëposhtë:

**1. Deklarata.** Nëse Ju dëshironi ta shfrytëzoni këtë mundësi duhet ta deklaroni këtë duke plotësuar formularin përkatës.



Debreceni iroda

**2. Blerja:** Sistemi e zbrit automatikisht uljen në çmim nga shuma gjithsej. Por kjo shumë për çdo person nuk mund të kalojë 35% të shumës gjithsej neto. Nëse ulja e mbledhur në emrin Tuaj është më e madhe se kjo shumë, atëherë shumën e mbetur ua llogarisim gjatë blerjes së ardhshme, përsëri deri në vlerën 35% të shumës gjithsej të re, pastaj ky proces përsëritet mëtej.

Në rastin e blerjes me ulje nevojitet vërtetimi i identitetit Tuaj ose i personit të autorizuarit me letërnjoftim me fotografi.

**3. Informimi:** Shumës që mund të merret në përdorim në datën 15 të çdo muaji i shtojmë uljet e reja që rrjedhin nga blerjet e muajit të kaluar. Rreth shumës aktuale të uljes kolegët tanë mund t'ju japin informacione juve ose personit të autorizuar vetëm personalisht, pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi.

Për detaje të mëtejshme interesohuni tel sponsorët ose punonjësit tanë.

### TRANSPORTI

Dëshiroj t'u thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Ju i marni porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – në kohë të përcaktuar – në çdo zonë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anulohet dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania.

### INFORMACIONE ME VLERË

I lutemi Distributorëve të Nderuar, që bashkë me formularin e tyre të regjistrimit të

dorëzojnë edhe kopjen e lishencës së tyre! Në të ardhmen vetëm me këtë dokument mund t'u japim shpërblime! Ata partnerë të Hungarisë, të cilët për blerjet e bëra dëshirojnë të nxjerrin llogari në emrin e firmës së tyre personale, mund ta bëjnë këtë vetëm në rast se dërgojnë formularët e nevojshëm të plotësuar, dhe një kopje të dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i firmës. Njoftimi i hollësishtëm në lidhje me këtë gjendet në zyrat tona, por me kërkesën tuaj mund t'ju njoftojnë edhe gojarisht.

### Numrat telefonik të specialistëve tanë mjek:

**Dr. Kassai Gabriella** 20/234-2925

**Dr. Kozma Brigitta** 20/261-3626

**Dr. Mezösi László** 20/251-9989

**Dr. Németh Endre** 30/218-9004

**Siklósné dr. Révész Edit** 20/255-2122

### Numri telefonik i specialistit tonë mjek të pavarur:

**Dr. Bakanek György** 20/365-5959

### Produktet e Forever Living Products i nxjerrim në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

### PËRFAQËSITË TONA

#### Forever Living Products

- Drejtoria Qendrore:  
1067 Budapest, Szondi utca 34.,  
tel: +36-1-269-5370, +36-20-253-3614
- Drejtoria e Tregëtisë e Budapestit:  
1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11.,  
tel: +36-1-291-8995, +36-20-465-6280  
Drejtori i tregëtisë: Dr. Gothárd Csaba
- Drejtoria Rajonale e Debrecenit:  
4025 Debrecen, Erzsébet u. 48.,  
tel.: +36-52-349-657, +36-20-914-2945  
Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Drejtoria Rajonale e Szegedit:  
6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25.,  
tel: +36-62-425-505, +36-20-251-1712  
Drejtori i rajonit: Radóczki Tibor
- Drejtoria Rajonale e Szekesfehervarit:  
8000 Székesfehérvár, Sóstói út 3.,  
tel: +36-22-333-167; +36-20-467-8603.  
Drejtori i rajonit: Földi Attila

#### Forever Resorts

- Hoteli Késhtjella e Szirakit  
3044 Szirák, Petőfi u. 26.  
tel: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285.  
Drejtoresha e hotelit: Király Katalin



Më lejoni t'ju rekomandoj restorantin tonë që gjendet në lagjen me kopshte Pestszentlőrinc. Në kuzhinën tonë kërkesat tuaja priten nga kuzhinierë të zgjedhur të cilët bashkëpunojnë ngushtë me personelin e restorantit tonë të njëjtë në **Hotelin Kështjella e Szirakit**. Gjatë përgatitjes së menisë morrëm parasysh kriteret e kuzhinës moderne, si dhe u përpoqëm t'i mbetemi besnik atmosferës së kështjellës. Si rezultat i kësaj në zgjedhjen tonë gjenden ushqime kafshësh të egra, fileto mishi dhe kërmij. Qejflinjte e të ngrënit i presim me lloje të ndryshme verërash dhe rakish në dhomën e duhanit në katin e parë. Çdo ditë mysafirët e dashur i presim me menu të ndryshme dhe a la cart! Në restorantin tonë mund të zhvillohen aktivitete, takime familjare, dreka dhe darka biznesi me nivel. I presim me kënaqësi mysafirët!

***Për mysafirët sigurojmë parkim me roje. Rekomandohet rezervimi përpara i tavolinës!***

## I PRESIM ME KËNAQËSI MYSAFIRËT!

**Orari i hapjes: çdo ditë 10.00 – 21.00**

**1183 Budapest, Fonal utca 2/a. ; Telefon: +36-1-291-5474 • Mail: [sasfeszek@foreverliving.t-online.hu](mailto:sasfeszek@foreverliving.t-online.hu)**

# Njoftimet e zyrave juglindore



## NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381-24-792-195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

- Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.
- Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse

- porosia e bërë në një numër kodit e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

## NUMRAT E TELEFONIT TË SPECIALISTËVE TANË MJEK TË SERBISË:

**Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević:**

+381-23-543-318. Ata i presin thirrjet tuaja për konsultim të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00.

**Dr. Božidar Kaurinović** të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret thirrjet tuaja për konsultime në numrin e telefonit +381-21-636-9575.



## NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI


- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića 20., Tel. +382-20-245-412, tel/fax: +382-20-245-402, Orari i punës: të hënën: 12:00 – 20:00 Në ditët e tjera të punës: 9:00 – 17:00, E shtuna e fundit e çdo muaji është ditë pune. Orari i punës: 9:00 – 14:00 Drejtor rajonal: Aleksandar Dakić

- Porosi produktesh mund të bëni në numrat telefonik të mëposhtëm: +382-20-245-412; +382-20-245-402. Pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e produktit të porositur e kalon 1 pikë, shpenzimet e transportit i merr përsipër FLP-ja.

## NUMRI I TELEFONIT TË SPECIALISTES MJEKE TË MALIT TË ZI:

**Dr. Laban Nevenka:**

+382-69-327-127



## NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË

- Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.ü Njoftojmë punonjësit dhe konsumatorët tanë se zgjatëm orarin e hapjes së zyrës së FLP-s së Zagrebit: të hënën dhe të enjten: 09:00 - 20:00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09:00 - 17:00. Tel: +385-1-3909-770 dhe fax: +385-1-3909-771. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

- Porosia telefonike: +385-1-3909-773. Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti, çmimi i transportit paguhet nga FLP-ja.
- Mësim në lidhje me produktet mbahet të hënën, të martën dhe të mërkurën nga ora 17.
- Nëse vlera e produkteve të blera është më e madhe se 1500 kuna, me kartë Diners kjo shumë mund të paguhet në 2-3 pjesë.

## KËSHILLTARJA JONË MJEKE NË TELEFON:

**Dr. Ljuba Rauški Naglič,** në ditët teke: 16:00 – 20:00.

Celulari: 091 51 76 510.



**Zágrábi iroda**





## NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



**Zyra e Bijelinës**

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00. Dr. Slavko Paleksic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i zyrës: Enra Hadžović

– Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784, Bijelinë dhe +387-33-760-650 Szarajevë.

### NJOFTIM I ZYRËS SË FLP-S SË SARAJEVËS

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.



## NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLOVENISË

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava.tel.: +386-2-575-12-70, Fax: +386-2-575-12-71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

– Ju njoftojmë që pranë zyrës së Trzinit funksionon edhe salloni i kozmetikës dhe masazhit Sonya. Për informacione të mëtejshme dhe lënie orari takimi interesohuni në numrin e telefonit 01/562-36-40. Presim paraqitjen tuaj!

– Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501 Në rast të porosisë në telefon, mallin e dërgojmë në adresën që i përket kodit. Distributorët që duan të porosisin mall në emër të një distributori tjetër, duhet të kenë autorizim nga distributori në emrin e të cilit duan të bëjnë porosinë. Formularët e autorizimit mund të sigurohen në zyrë. Malli i porositur në telefon transportohet për dy ditë pune!

### NUMRAT E TELEFONIT TË SPECIALISTËVE TANË MJEK TË SLOVENISË: Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788



**Zyra e Lendvait**



## NJOFTIMET E ZYRËS SË SHQIPËRISË

- Shqipëri, Tiranë, Reshit Collaku 36. tel/fax: +355 42230 535. Drejtori rajonal: Attila Borbath Drejtori i zyrës: Xhelo Kiçaj, tel/fax: +355-694066 811. Kontaktim: në ditët e punës 9-13, 16-20 e-mail: flpalbania@abcom.al



**Zyra e Shqipërisë**



## NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

- Prishtinë, Rr. Uçk br. 94, tel.: +381-38-240-781, +377-44-503-911.

# Shikon qartë vetëm duke menduar...

## PASI NDRYSHE VETËM VËSHTRON

Të vështrosh, të hedhësh një sy? Apo të shikosh qartë duke menduar? Për mua ndryshimi është i qartë. Me siguri mosha, përvoja dhe koha ua jep njerëzve këtë aftësi.

**F**ëmijët dhe ndërtimi i biznesit erdhën shpejt njëri pas tjetrit në jetën time. Forca e të resë pati efekt tek unë prej të dyjave (detyra e panjohur, sfida, matja e vetvetes), megjithatë secila në mënyrë të ndryshme. Njërin e doja shumë dhe e prisja prej 6 vitesh, kurse tjetren nuk e doja dhe më gjeti vetë.

Para se të mbaronte leja e lindjes kërkova rrugëzgjdhje që si nënë me 2 fëmijë ku mund të gjeja një punë "nënash" elastike, me pagesë të mirë dhe që toleron problemet me fëmijët, sepse bashkëshorti im falë punës së tij tepër elastike (hoteleri) si në përralla: herë ishte, herë nuk ishte!

Në periudhën e kërkimit Angelika Szidiropulosz ishte ajo që më tregoi çelësin e zgjidhjes, dhe për 2 vjet me radhë si një mësuese e mençur me një durim të madh ma solli pas në një jastëk kadife, ndërkohë që vështroja nga distanca jetën e çuditshme, ndonjëherë për t'u patur zili të rrjetndërtuesve, por unë e refuzoja. Në një farë mënyre më tërhiqte kjo jetë, por në asnjë mënyrë s'e imagjinoja dot veten brenda saj. Nuk e shikoja mundësinë time brenda kësaj mundësie!



Pamja dalëngadalë po qartësohej. Mendimet, paragjykimet e mia rreth rrjetndërtuesve dhe ndërtimit të rrjetit ndryshuan, fillova ta shikoja ndryshe. Në vend të njerëzve mendjemëdhenj, snob, të pasur dhe që buzëqeshin vazhdimisht: ata, dhe bashkë me ta edhe unë, u bënë NJERËZ të vendosur, të qëllimshëm, me kërkesa, me siguri materiale, këmbëngulës, me dëshirë për të mësuar, të aftë për t'u zhvilluar, që punojnë shumë.... nxënë, bashkëshortë, bashkëshorte, baballarë, nëna.

Ndryshoi edhe pamja e ndërtimit të rrjetit dhe e botës. Problemet morrën forma të tjera, detyrat u bënë sfida, detyra për t'u zgjidhur.

Bota u bë më e kuptueshme dhe më paqësore!

Gjeta atë që kërkova dhe që përmban në vetvete mundësitë e kërkua prej të gjithëve, pikërisht mungesat e shoqërisë së sotme. Sigurinë, miqtë, mësimin, zhvillimin, suksesin, respektin, paranë, udhëtimin, vlerësimin.



**BEATA TASNADY**  
menaxhere

*"Mësoji njerëzit të shikojnë, sepse ajo që bën me të tjerët, në një farë mënyre mbetet përgjithmonë e jotja!"*

# New Distributor Pricing

## PËRSHPEJTO BIZNESIN TËND!

**Të gjithë e dinë se çfarëdo motori nëse i shtojmë bateri turbo, i rritet në mënyrë drastike forca. Çfarë do ndodhte nëse do e përshpejtoje rritjen tënde dhe përfitimin nga biznesi yt duke i shtuar një bateri turbo? Apo do ishte më mirë t'i shtonin një bateri turbo çdo distributori në skuadrën tënde? Do të ishte si një ngarkim superturbo i biznesit tënd! Dhe është pikërisht kjo ajo që FLP bëri me funksionimin e New Distributor Pricing (NDP = çmimi i distributorit të ri)!**

Të shikojmë pak rrethanat që ngadalësojnë rritjen e distributorëve fillestarë. Shumë prej nesh janë përballur me problemin që si distributor është detyra e tyre apo jo sponsorizimi sipas planit marketing i klientëve të tregëtisë me pakicë. Shkaku i këtij është që nëse i sponsorizojnë ata, atëherë e humbasin Retail Profit-in (përfitimi nga tregëtia me pakicë) në shitje; por nëse nuk i sponsorizojnë ata atëherë ekziston mundësia që i sponsorizon dikush tjetër. Kjo dilemë përforcohet mëtej nëse marrim parasysh që baza e planit marketing është që çdo Asistent Supervisor dhe nivel që ndodhet mbi të mban një bazë të fortë blerësisë, të cilët çdo muaj sjellin 4 CC. Pra si mund të rritet më shumë biznesi me sponsorizim ndërkohë që e mbajmë dhe e ruajmë rrethin e blerësve tanë?

New Distributor Pricing e bën distributorin të aftë të sponsorizoj blerësit e tij, të mbaj rrethin e blerësve dhe një pjesë nga profiti i krijuar. Çfarë gjenialiteti! Kjo i motivon distributorët jo vetëm që t'i sponsorizojnë blerësit e tyre dhe të përfitojnë prej kësaj, por edhe i nxit blerësit që të bashkohen me ne dhe t'i provojnë produktet me çmim shumicë!

Të shohim si funksionon:

Gjatë sponsorizimit një distributor i ri blen drejtpërdrejt nga kompania me çmimin e distributorit të ri (NDP). Ky është 15 % më i ulët se sa çmimi i tregëtisë me pakicë i rekomanduar (SRP).

Pasi çmimi i tregëtisë me shumicë (Wholesale Price) është 30% më i ulët se sa SRP (çmimi i tregëtisë me pakicë i rekomanduar) diferenca prej 15 % i paguhet sponsorit. Sponsorit e merr këtë bonus derisa distributori i ri të kualifikohet në nivelin e Asistent Supervisorit.

Psh. të supozojmë se ti je një Asistent Supervisor dhe sponsorizon një distributor të ri i cili porositi 6 bidona Aloe Vera Xhel. Mëposhtë po tregojmë ndryshimin ndërmjet çmimit të distributorit të ri (NDP) dhe çmimit të tregëtisë me shumicë (Wholesale Price) që i paguhet sponsorit:

6 x € 25,93(SRP)	= € 155,58 gjithsej
6 x € 22,00(NDP)	= € 132,00 kjo paguhet nga distributori i ri
6 x € 18,16(Wholesale)	- € 108,96 gjithsej
	€ 23,04 Kjo shumë i paguhet sponsorit nëse ndodhet në nivelin e Asistent Supervisorit ose në nivel më të lartë

SRP= çmimi i tregëtisë me pakicë i rekomanduar

Wholesale= çmimi i tregëtisë me shumicë

Nëse një distributor i ri kualifikohet si Asistent Supervisor, meqë blen 2 CC në 2 muaj që vijnë njëri pas tjetrit, mund të blej me çmim tregëtie shumicë (Wholesale Price). Kjo do të thotë që ai përfiton gjithë çmimin e tregëtisë me pakicë për çdo blerje të bërë me tregëti pakice, plus bonusin e çmimit të distributorit të ri për çdo distributor të ri që sponsorizon.

Një nga përparësitë e rëndësishme të çmimit të distributorit të ri (NDP) është që edhe distributorët e rinj, përshembull Asistent Supervisorët dhe Supervisorët të shijojnë të ardhura më të mëdha ndërkohë që ndërtojnë nivele më të larta, sepse përveç bonuseve personale marrin edhe të ardhura nga blerjet e distributorëve të rinj.

Falë NDP ekziston një proces prej 3 hapash, me të cilin mund të motivosh distributorët e rinj që të bëhen rrjetndërtues!

### 1. HAPI I PARË

Marrin 15 % ndryshim çmimi nga distributorët e rinj

### 2. HAPI I DYTË

Si Asistent Supervisor marrin 30 % ndryshim çmimi + 5% bonus personal

### 3. HAPI I TRETË

Sponsorizo të tjerët: për NDP + bonus personal

Çdo hap i nxit distributorët e rinj të jenë kompetent në çështjet e kompanisë dhe të kenë besim në planin marketing.

Nëpërmjet kësaj kandidatët e rinj janë të motivuar të bëhen distributor sepse kështu mund t'i blejnë produktet me 15 % ulje çmimi (NDP). Si distributor të rinj mund të motivohen mëtej për të arritur nivelin e Asistent Supervisorit, sepse kështu mund t'i blejnë produktet me 30 % ulje çmimi (Wholesale Price), si dhe mund të marrin edhe 5 % bonus personal. Si Asistent Supervisor do të jenë prapë të motivuar të sponsorizojnë të tjerë në mënyrë që të përfitojnë çmimin e distributorit të ri (NDP) dhe bonuset për blerjet e bëra nga njerëzit e rinj.

Pra përshpejto biznesin tënd me ndihmën e plotësimin të ri të planit tonë marketing!

Mësoi distributorët e tu që ta kuptojnë se ky përmirësim i konsiderueshëm mund t'i ndihmojmë, sidomos Asistent Supervisorët të përfitojnë të ardhura të menjëhershme. Dhe rezultatet ke për t'i parë së shpejti në llogarinë tënde bankare!



Forever Living  
Products Hungari  
Shpk shpall konkursin  
e kërkimit të talenteve  
me emrin **“Yjet e  
FLP-s”**, ku mund  
të marrin pjesë  
distributorët  
e kompanisë.

## Qëllimi i konkursit

Qëllimi i konkursit është: zbulimi dhe prezantimi para publikut i talenteve, personave të njohur apo të panjohur deritani, të cilët japin rendimente të larta në fushën e artit, prezantojnë shfaqje me nivel të lartë.

Nuk bëjmë dallim ndërmjet lektorëve profesionist dhe amator, pra gjatë gjykitimit s'do të ketë vlerë e shkuara, rezlutatat e arritura, por vetëm shfaqja që prezantohet.

## 1. Kushtet e regjistrimit:

- 1.1. Fletë regjistrimi e plotësuar me saktësi dhe e dorëzuar në kohë.
- 1.2. Të regjistruarit duhet të jenë të paktën distributor me 2 cc (asistent supervisor).
- 1.3. Në rast grupi më shumë se gjysma e anëtarëve të tij duhet të jenë asistent supervisor. (Pra në rast të një grupi me 6 persona 4, kurse në rast të një grupi me 9 persona 5 prej tyre duhet të jenë distributor me 2 cc.)
- 1.4. Mënyra e dorëzimit të fletave të regjistrimit:
  - personalisht në drejtoritë rajonale përkatëse,
  - me postë në formë letrë me rekomandim drejtuar po këtyre,
  - me e-mail.
- 1.5. Kufiri kohor i regjistrimit: 31 tetor 2009 (Në postë data e dërgimit nuk mund të jetë më vonë se kjo datë.)

## 2. KATEGORITË:

- 2.1. Muzikë (Shfaqje muzikore vokale dhe instrumentale, këngë solo, etj)
- 2.2. Lëvizje (Kërcim, pantomim, gjimnastikë artistike, etj)
- 2.3. Të tjera (Çdo shfaqje tjetër skenike – që nuk mund të radhitet në kategoritë e mësipërme.)



# CSILLAGAI

## 3. Kriteria të mëtejshme:

- 3.1. Koha e shfaqjes të jetë të paktën 3 minuta dhe e shumta 10 minuta.
- 3.2. Kërkesat teknike të disa shfaqjeve duhet t'i theksoni në fletën e regjistrimit. Nga këto tekniken bazë – përshembull ndriçimin, amplifikimin – e sigurojmë ne.
- 3.3. Pajisjet, kostumet, shoqërimi muzikor i nevojshëm apo sigurimi, operimi, transporti i elementeve të ndryshme që i përkasin shfaqjes është detyra e pjesëmarrësit.

Nëse ndjen talent në vetvete, nëse ke dhënë prova në ndonjë degë të artit apo dëshiron ta provosh vetveten, paraqitu në këtë konkurs! Gjithë distributorëve të dashur, entuziast dhe të talentuar që nisen në këtë konkurs u urojmë përgatitje të mbarë dhe sukses!

**DR. SANDOR MILESZ**  
*drejtor gjeneral*  
**ZSOLT FRENKO**  
*drejtues artistik*

## 4. Gjykimi, konkurset eliminatorë:

- 4.1. Konkurset eliminatorë – në rastin e numrit të duhur të pjesëmarrësve – i organizojmë në drejtoritë rajonale përkatëse.
- 4.2. Gjysëmfinalja organizohet në Budapest, ku marrin pjesë fituesit e konkurseve eliminatorë.
- 4.3. Shfaqjet do të gjykojnë nga artistë të njohur të Hungarisë, juria me tre anëtarë i vlerëson me sistem pikësh shfaqjet e prezantuara.
- 4.4. Si rezultat i vlerësimit me pikë mund të ndodh që as fituesja e konkursit të ndonjë rajoni nuk hyn dot në gjysëmfinale, pasi ndërmjet konkursesve të një rajoni tjetër mund të ketë nga ata që kanë arritur një vend më të ulët, por një numër më të madh pikësh.
- 4.5. Natyrisht edhe fituesit e konkurseve eliminatorë rajonale do t'i shpërblejmë në një farë forme.

## 5. Finalja dhe shpërblimi i fituesve:

- 5.1. Shfaqjet e vlerësuara si më të mira në gjysëmfinalen e Budapestit dalin në skenën e Arenës Sportive Laszlo Papp të Budapestit.
- 5.2. Pra finalja zhvillohet para publikut të Success Day, nga shkurti i vitit të ardhshëm.
- 5.3. Juria vlerëson me të njëjtin sistem pikësh si në konkurset eliminatorë dhe në gjysëmfinale.
- 5.4. Për çdo kategori do të japim nga një çmim fitues, si dhe publiku mund të votojë për shfaqjen më të këndshme dhe më me nivel sipas tij.
- 5.5. Shpallja e rezultatit, ceremonia e fituesve dhe dhënia e çmimit "Yjet e FLP-s" bëhet në aktivitetin e dhjetorit 2010, në skenën e Arenës Sportive Laszlo Papp të Budapestit.

# I punonjësve të Qendrës Mësimore Sonya të rrugës Nefelejcs

Pa zhurmë bie shiu i vakët i cili duke u spërkatur lehtë përhapet në degët e bredhave, ndërkohë që unë dalëngadalë shkoj nga Restoranti Foleja e Shqiponjave drejt Sallonit Sonya. Çfarë ndjenje është të njohësh një njeri tjetër? Një kulturë tjetër? Pasi hap derën aty ulet në kolltuk një krijesë e vogël, një femër e buzëqeshur, e cila s'është tjetër veçse masazhatorja jonë tailandeze: **Pratchayaporn Inprasit Mingi**



– Flas pak hungarisht – thotë dhe tund kokën duke buzëqeshur. Vesh shpejtë xhakëtën e saj dhe ulemi të bisedojmë në Sallonin Mësimor Sonya.

**– Si erdhe në FLP?**

– Punoja në Termal Hotel të Visegradit kur u njoha me drejtorin e kompanisë, Dr. Sandor Milesz. Atij i pëlqeu puna ime dhe më ftoi të punoja këtu në Sallonin Sonya të rrugës Ne-felejs dy herë në javë.

**– Kaq punon gjatë gjithë javës?**

– Sigurisht që jo! Të premten, të shtunën dhe të djelën jam në Szirak, ku shërbej mysafirët e atjeshëm.

**– Ku ke lindur? Si erdhe në Hungari?**

– Erdha këtu nga Tailanda para dy vjet e gjysëm.

**– Vetëm erdhe?**

– Po. Atëherë morri fund një marrëdhënie dashurie, dhe mendova ta ndryshoj plotësisht jetën time.

**– E vështirë ishte të ndaheshe nga shtëpia?**

– Shumë. Edhe për faktin sepse jam fëmijë e vetme. Tek prindërit lashë qenin tim të vogël 4 vjeç, një shiutsu i cili quhet Momman. Ai më mungon shumë. Në shtëpi jetonim veç e veç... dhe kështu ai flinte në krevatim tim.

**– Këtë e kuptoj. Çfarë bën gjatë 2 ditëve pushim?**

– Jam para internetit, flas me prindërit e mi, është një mundësi e shkëlqyer lidhjeje. Takohem me miqtë e mi të cilët gjithashtu punojnë këtu në Budapest, gatujmë ushqime tailandeze, dhe mësoj anglisht.

**– Vërtetë, mësim. Ku e ke mësuar masazhin tailandez?**

– Në Shkollën e njohur të Mjekësisë Tradicionale Wat Poo të Bangkokut për-vetësova lëvizjet qindra vjeçare, dhe këtu morra diplomën e mjeshtrit. Unë bëj masazhin tradicional tailandez i cili sjell në ekuilibër elementët e trupit duke aktivizuar energjitë e tij. Rrënjët e tij i përkasin Indisë së lashtë.

**– Si ndodh ky masazh?**

Duke u shtrirë në një dyshek të madh me bazë natyrale. Mysafiri vishet me rroba si pizhama pambuku, vetëm këmbën ka zbathur. Nga këmbët ngjitem lart, dhe me shtypje ritmike përiqem të aktivizoj pikat fiziologjike sipas linjave Zen, linjave energjike të trupit. Efekti i këtyre mund të shtohet me

kërcitjen dhe lëvizjen e pjesëve të ndryshme të trupit. Ky masazh ka koreografinë e vet, pasi masazhatori përveç duarve përdor edhe gjurin dhe shputën.

**– Ecën mbi njerëzit?**

– E kryej masazhin tailandez duke marrë parasysh aftësitë e klientit, pasi ky quhet masazh i thatë, ku ndodhet vetëm mysafiri, unë dhe njohuritë e mia. Si rrjedhim i ndërveprimit të niveleve energjike të masazhatorit dhe klientit shpeshherë mund të arrihet një rezultat i pabesueshëm gjatë një ore e gjysëm!

**– Pasi merr fund ndrysia mund të shkojmë me vrap?**

– S'është plotësisht kështu. Efekti i masazhit tailandez në radhë të parë fshihet në ekuilibrimin e sistemit energjistik. Pikësynimi i tij është zbutja e dhembjeve dhe tensioneve fizike dhe shpirtërore, arritja e një gjendje kënaqësie dhe të qetë. Në fund është mirë të shplohesh, të relaksohesh pak, dhe të kthehesh gradualisht në aktualitet.

**– Fole aq bukur rreth kësaj, sa që më lindi dëshira për një masazh!**

– Atëherë më merr në telefon dhe lemë një orar takimi!

**– Punon me orar takimi?**

– Po, për fat të mirë kam edhe klient të përhershëm.

**– Merr përsipër edhe lloje të tjera masazhi?**

– Po, i pres lexuesit edhe për masazh tailandez këmbësh dhe trupi me vaj. Por ai që më shikon, kërkon menjëherë masazh tailandez, pasi klientët e dinë se nga unë marrin origjinalin dhe nuk frikësohen as nga përmasat e mia të vogla.

**– Dukesh shumë e re. Më lejon të pyes se sa vjeç je?**

– Po, për ju këtu në Europë kjo është interesante, ne dukemi të rinj, megjithëse jam 38 vjeç.

**– Këtë s'do e kisha menduar kurrë! Familje? Burrë? Fëmijë?**

– Tani përqëndrohem vetëm tek puna, por natyrisht edhe unë dëshiroj të krijoj familje.

**– Përdor edhe vetë ndonjë produkt, apo i përdor ata vetëm për masazh trupi dhe shpate?**

– Shiko bryllat e mi, i shikon këto puçrat e vogla të kuqe, këto mund t'i trajtoj vetëm me krem aloe dhe first. Më pëlqejnë shumë.

**– Mingi, të falenderoj shumë që më dhe mundësinë të takohemi për t'u njohur në ditën tënde të pushimit. Shpresoj se pas leximit të artikullit s'do të kesh klient të përhershëm vetëm në Szirak, por edhe në rrugën Nefelejcs.**

– E di çfarë? Eja me mua të të bëj një masazh!

..... Kaluan disa orë dhe vazhdoj të shkruaj. Ankthi që kisha përbrenda m'u zhduk plotësisht. Mingi më bëri masazh të këmbëve, pastaj duke kaluar dalëngadalë nga kërcinjt u ngjit drejt trupit. Pa përjashtuar as shpinën, qafën dhe kokën. Pasi eci mbi gjithë shpinën, trupi im filloi të reagoonte ndaj çdo lëvizjeje. Kisha besim tek ajo, ndonjëherë në takohet shikimi, por e kuptuam njëra tjetrën pa fjalë. Prej saj rrezatonte qetësia dhe siguria.

I ndjej mirë të gjitha kërcet e mia. Lëviz në mënyrë elastike, më përkulet gjuri, e kam të lehtë qafën. Më pëlqen shumë jeta! Më gëzon shpirti dhe më buzëqesh fytyra. Në jetën tonë qytetare të përshtypshme masazhi i Mingit përbën shplohjeje. Merre menjëherë në telefon dhe kërkoji takim!



**UNGAR KATA**  
menaxhere

**NË SALLONIN SONYA TË RRUGËS NEFELEJCS**

**Masazh: Csilla Fülöp (+36-20) 981-7894**

**Kozmetikë: Ivet Racz (+36-20) 416-6329**

**Manikyr, pedikyr: Krisztina Hasznosi (+36-20) 594-7437**

**Parukeri: Robert Horvath (+36-20) 369 7579**

**NË SALLONIN SONYA TË RRUGËS SZONDI**

**Masazh: Ildiko Hrncsjar (+36-20) 457 1155**

**Kozmetikë: Ildiko Bagi-Meszaros (+36-20) 500-3889**

Punonjësit tanë ju presin të gatshëm për t'ju bërë qejfin. Hapni fletoren e takimeve dhe binduni për besueshmërinë e fjalëve të mia! Ju uroj të kaloni një kohë të këndshme!

www.flpseeu.com

**FOREVER**

**SHTYPI**

**Botuese:** Kompania Forever Living Products, Hungari. • **Redaktori:** FLP Magyarorszag Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

**Redaktori kryesor:** Dr. Milesz Sandor **Redaktor:** Kismarton Valéria, Petröczy Zsuzsanna, Pósa Kálmán, Rókás Sándor, Földi Attila • **Përgatitja për shtypje:** Tipofill 2002 kft.

**Grafika:** Teszár Richárd, Buzássy Gábor, **Fotograf:** Attila Maklári Tóth, Darko Baranašić • **Shtypi:** Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 36 500 koje • **Përthyes, redatues:** shqip: Dr. Marsel

Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko – serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana

Për përbajtjen e artikujve shkruesit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!



# RALLY EUROPIAN 2010

ANGLI, LONDËR – 4-6 MARS

Periudha e kualifikimit: 1 Korrik deri në 31 Tetor

## NIVELI 3

Plotësoni 95 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ Bileta hyrje në Rally
- ★ 3 netë në hotel
- ★ udhëtimi me avion



## NIVELI 2

Plotësoni 50 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re


- ★ Bileta hyrje në Rally
- ★ 3 netë në hotel



## NIVELI 1

Plotësoni 20 CC (bashkë me pikët personale) me skuadrën tuaj të re

- ★ Bileta hyrje në Rally



**Kushtet e reja të kualifikimit për në çdo nivel: Sponsorizoni të paktën tre distributor të gjeneratës së parë të cilët arrijnë nivelin e Asistent Supervisorit. Çdo distributor i ri duhet të arrijë vlerat e pikëve të dhëna në figurë. I kualifikuari të jetë "Aktiv" në të tre muajt e periudhës së kualifikimit. Periudha e kualifikimit zgjat nga 1 korrik 2009 deri më 31 tetor 2009. Gjithë kushtet duhen plotësuar gjatë periudhës së kualifikimit. Distributorët e rinj duhen regjistruar gjatë periudhës së kualifikimit, dhe ndërmjet tyre ai që dëshiron të kualifikohet duhet të jetë aktiv që në muajin e hyrjes. Data e hyrjes është ajo e regjistrimit të të dhënave të tij në sistemin kompjuterik të kompanisë qëndrore. Në këtë program motivues kanë vlerë vetëm blerjet e bëra brenda rajonit. Çdo distributor i linjës së poshtme duhet të zotërojë adresë brenda rajonit. Çdo distributor mban përgjegjësi për kuptimin e duhur të kushteve të programit motivues. Nuk ekziston mundësia e trajtimit të veçantë. Programi motivues përmban vetëm kushtet dhe shpërblimet e shfaqura në figurë. Për çdo pyetje që keni drejtohuni Drejtorit tuaj gjeneral. Shpërblimet nuk mund të shkëmbehen në para. Shpërblimet nuk mund t'u jepen të tjerëve.**



## EUROPEAN RALLY & PROFIT SHARE



FOREVER  LONDON

## DATA DHE ORARE

Data e Rally-t:

5 mars 2010, të premten, 6 mars 2010, të shtunën

Ashtu si në aktivitetin Rally European & Profit Sharing të 2009-ës në Malaga, edhe tani kualifikimet Profit Sharing do të mbahen në të dyja ditët. Orari i saktë i programit të Rally-t s'dihet akoma, por pritet të jetë i njëjtë me atë të Malagës: 13.00-19.30 (të premten) dhe 11.00-17.00 (të shtunën). Pas një konsultimi të gjatë vendosëm që në këtë Rally të mos organizojmë Banket për Të Kualifikuarit. Kjo u jep pavarësi më të madhe individëve dhe grupeve që të shtunën në darkë të organizojnë programe.



### VENDI I ORGANIZIMIT

Vendi i organizimit të Rally-t është: **Wembley Arena**. Gjendet 12 km larg qendrës së Londrës dhe mund të shkohet thjeshtë me metro, tren, autobus dhe makinë. Adresa e faqes së internetit: [http://www.wembley.co.uk/Wembley\\_Arena.htm](http://www.wembley.co.uk/Wembley_Arena.htm)



### BILETAT E RALLY-T

Biletat sigurojnë pjesëmarrje në programin e të dyja ditëve. Për të pakualifikuarit sigurojmë bileta nga nëntori.



### AEROPORTI

Transporti do të bëhet nga aeroportet e mëposhtme:  
LONDON HEATHROW  
LONDON STANSTED  
LONDON LUTON



### HOTELET

Të kualifikuarit do të strehohen në këto hotele:  
HILTON ON PARK LANE HOTEL  
GROSVENOR HOUSE HOTEL  
GROSVENOR SQUARE HOTEL  
HYATT REGENCY HOTEL  
HILTON PADDINGTON HOTEL

Ndarjen sipas shteteve do e dërgojmë pas mbylljes së periudhës së kualifikimit dhe njohjes së numrit të plotë të të kualifikuarve.



### MOTI

Kjo është Londra, Anglia – e njohur rreth shirave, prandaj përgatituni. Temperatura pritet të jetë 3-10°C, merni me vete çadër dhe rroba të trasha!

Ju presim me kënaqësi në Londër!



FOREVER  RESORTS

# Sonya Wellness

pishina | xhakuzi | dhomë kripe | sauna  
masazh | kozmetikë | parukeri | bar pijesh

pools | spa | salt chamber | sauna  
massage | beauty-shop | drinkbar



# OFERTAT TONA ME ULJE ÇMIMI



## OFERTA ME ULJE ÇMIMI PËR ATA QË VIJNË TË DJELËN:

Dy netë në dhomë me dy krevatë në ndërtesën kryesore me ardhje të djelën:

**23.450 Ft/person në vend të 28.900 Ft/person**

Tre netë në dhomë me dy krevatë në ndërtesën kryesore me ardhje të djelën:

**35.250 Ft/person në vend të 43.350 Ft/person**

Dy netë në dhomë me dy krevatë në ndërtesën në krahë me ardhje të djelën:

**17.850 Ft/person në vend të 21.900 Ft/person**

Tre netë në dhomë me dy krevatë në ndërtesën në krahë me ardhje të djelën:

**26.800 Ft/person në vend të 32.850 Ft/person**

## DHURATË E PAHARRUESHME

për prindërit tanë në rast martesë, ditëlindjeje, krishtëlindjesh apo festash të tjera.

Çmimi i ofertës: **94.750 Ft/2 persona/3 netë, 123.850 Ft/2 persona/4 netë**

Oferta përban shërbimet e mëposhtme:

- Surprizë në dhomë
- Fjetje në apartament të zgjedhur të Hotelit Kështjellë
- Në një mbrëmje darkë romantike nën dritën e qirinjve
- Përdorimi i pishinës, saunës, kabinës së kripës dhe xhakuzit në pjesën Wellness.

Ofertën e ndryshojmë me gjithë kënaqësi sipas dëshirave tuaja.

Paraqituni me besim.

## OFERTË MUAJI MJALTI

Vazhdimi i denjë i një dite të paharrueshme...

oferta e Hotelit Kështjellë për udhëtarët e muajit të mjalit

Në hotelin tonë me atmosferë të ngrohtë, në hanin tonë familjar, udhëtarët e muajit të mjalit priten nga një ambient romantik.

**6 ditë/5 netë – 149.650 Ft/2 persona/5 netë**

Oferta jonë përban:

- Fjetje në apartamentin tonë
- Surprizë muaji mjalti në dhomë
- Mëngjes romantik i cili sipas dëshirës shërbehet në dhomë
- Darkë me tre pjesë
- Përdorimi i pishinës, saunës, kabinës së kripës, xhakuzit dhe fushës së tenisit në pjesën Wellness.

## OFERTA CLASSIC

• 3 netë me mëngjes në dhomë me dy krevatë në ndërtesën kryesore të kështjellës

• 3 darka me 3 pjesë në restorantin tonë

• 1 herë kalorësim në terren ose në stallë

**49.350 Ft/person**

Në rast përdorimi të një krevati **9000 Ft** ulje!

**I presim me kënaqësi gjithë të interesuarit!**  
**Telefon: (06) 32-485-300 • e-mail: [kastelyszirak@globonet.hu](mailto:kastelyszirak@globonet.hu)**



## Aloe Blossom Herbal Tea®

Çaji me bimë mjekësore i pasuruar me syth Aloe është një përzierje natyrale e gjetheve, bimëve mjekësore dhe erëzave, e cila na dhuron një shije dhe aromë të veçantë. Vepron tek ne duke na dhënë një ndjenjë rigjeneruese pa kofein. Sido që ta konsumojmë, të ftohtë apo të ngrohtë, Aloe Blossom Herbal Tea është një pije e shëndetshme që përgatitet lehtë dhe shumë e shijshme.

Ky çaj përgatitet nga lëndë bazë të zgjedhura me shumë kujdes me origjinë nga vende të ndryshme të botës, Kina, Xhamajka, Egjypti, Amerika dhe India. Kanella, lëkura e portokallit dhe karafil freskues i jep një shije të ngrohtë frutash, kurse pipëri xhamajkian dhe xhenxhefil kanë efekt qetësues. Duke e plotësuar me sythin Aloe Vera që vjen nga plantacionet tona përfitojmë një çaj freskues me përmbajtje të ulët kalorie edhe si plotësues i shkëlqyer i programit të kontrollit të peshës së trupit Forever Lite.

### Të dhëna shtesë:

Qese çaji (15gr)  
Në një kuti 25 qese çaji

Përmbajtja e një qeseje	vlera e kalorive	ditore në %*
yndyra	0 g	0 %
natrium	0 mg	0 %
karbohidrate	0 g	0 %
sheqer	0 g	
proteina	0 g	

\* Vlera ushqyese ditore në përqindje bazohet në një dietë që përmban 2000 kalori.

### PËRBËRËSIT:

Kanellë, lëkurë portokalli, karafil, gjethe manafere, piper xhamajkian, glikanxo, xhenxhefil, kardamom, syth aloe, ginnçma sylvestre, kamomil.

### PËRMBAJTJE:

1 kuti përmban 25 qese çaji plastike.

### DOZA:

Hedhim 1 qese në një gotë çaji, e mbushim atë me ujë të nxehtë dhe qesen e lemë brenda për 3-5 minuta para se ta heqim prej gotës.

Për përgatitjen e çajit të ftohtë hedhim



2 gota me ujë të nxehtë mbi një qese çaji, dhe e lemë për 3-5 minuta. Pasi e heqim qesen e çajit i hedhim edhe 2 gota me ujë të ftohtë, pastaj e konsumojmë pasi e ftohim.

- përmbajtje e ulët kalorie
- pa kofeinë

PRODUCT # 200